



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 22496 prot.

Shkodër, më 03 . 11 . 2025

VENDIM

Nr. 68, datë 31.10.2025

**“PËR DHËNIEN NË PËRDORIM PA KUNDËRSHPËRBLIM TË SIPËRFAQES PREJ 2
688 m² TRUALL DHE 674 m² NDËRTESE, OBJEKTI BORDI I KULLIMIT, PASURI
ME NR. 10/504 DHE NR. 10/80/2.ND, ZK 8593, NË FAVOR TË DREJTORISË SË
PËRGJITHSHME TË POLICISË SË SHTETIT”**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 31.10.2025, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 9, pika 1.2, germa a), dhe nenit 54, germa e/1), të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; të ligjit nr. 7850, datë 28.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; të VKM-së nr. 1108, datë 30.12.2015, “Për transferimin, nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të Bashkitë, të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të Bordeve Rajonale të Kullimit”; të VKM-së nr. 530, datë 25.09.2025, “Për shkëmbimin e pronës me emërtimin ‘Njësia e Sigurisë Publike Shkodër’, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Punëve të Brendshme, me pasurinë nr. 19/10, në ZK 3168, Shkodër, në pronësi të Bashkisë Shkodër”; si dhe dokumentacionin e përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër;

VENDOSI:

1. Të miratojë dhënie në përdorim pa kundërsHPërblim, për një periudhë 5 (pesëvjeçare), të objektit “Bordi i Kullimit”, me nr. pasurie 10/504 dhe 10/80/2 ND, ZK 8593, me sipërfaqe 2 688 m² (dymijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e tetë) truall dhe 674 m² (gjashtëqind e shtatëdhjetë e katër) ndërtesë, pronë e Bashkisë Shkodër, në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
2. Qëllimi i përdorimit të kësaj pasurie do të jetë ushtrimi i funksioneve nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

Miraturar me 38 vota

Vota Pro	38
Vota Kundër	0
Vota Abstenim	0
Zbardhur me datë	03.11.2025

SEKRETARE

Sabina Danaj

